



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PER CAKTIMIN E MEDIAVE DHE MIRATIMIN E PLANIT TE TRANSMETIMIT TË SPOTEVE
TELEVIZIVE DHE RADIOFONIKE PËR EDUKIMIN ZGJEDHOR TË SHTETASVE PËR ZGJEDHJET
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për caktimin e mediave dhe miratimin e planeve të transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23 pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencës së tij, përcaktuar në nenin 21, pika 9, të Kodit Zgjedhor, me vendimin nr. 20, datë 01.02.2019, ka miratuar "Strategjinë për edukimin zgjedhor të shtetasve për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30.06.2019".

Kuvendi i Shqipërisë, përmes Rezolutës "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2018", për vitin 2019 i kërkon KQZ:

- Të përpunojë strategjinë e përshtatshme të edukimit zgjedhor në përgjigje të rrethanave specifike politike.



Nr. 642 i Vendimit Data 23.05.2019 Ora 11.00 e Vendimit

Për caktimin e mediave dhe miratimin e planeve të transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike
për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës
30.06.2019

KQZ, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, synon realizimin e një fushate të plotë edukuese, informuese, sensibilizuese, ndërgjegjësuere për procesin zgjedhor të datës 30 qershor 2019.

Spotet televizive dhe spotet radiofonike, janë mjetet kryesore për informimin, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e shtetasve, si edhe grupimeve shoqërore me nevoja specifike, për pjesëmarrje në votim, informimin për të drejtat dhe detyrat e zgjedhësve në procesin zgjedhor, dhe për veprimet joligjore që çënojnë zgjedhjet e lira dhe demokratike. Transmetimi i spoteve televizive dhe radiofonike në media dhe fasha orare me shikueshmëri të lartë, dhe publikimet në shtypin e shkruar/gazeta i shërbejnë realizimit të këtij objekti.

Vendimi i KQZ nr. 20, datë 01.02.2019 "Për miratimin e strategjisë së edukimit zgjedhor të shtetasve për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30.06.2019", përcakton në pikën 3 të tij se media-plani i transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike, do të miratohet nga KQZ.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23 pika 1, germa "a", nenin 21, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Spotet televizive për informimin, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30.06.2019, do të transmetohen sipas planeve të transmetimit të paraqitur në lidhjet 1, 2, dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Spotet radiofonike për informimin, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30.06.2019, do të transmetohen sipas planeve të transmetimit paraqitur në lidhjen 4, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Publikimet për informimin, sensibilizimin, ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30.06.2019, do të realizohen sipas lidhjes 5, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 642 i Vendimit Data 23.05.2019 Ora 11.00 e Vendimit

Për caktimin e mediave dhe miratimin e planeve të transmetimit të spoteve televizive dhe radiofonike për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019